



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

DREJTORIA E POLITIKAVE EKONOMIKE DHE PROMOVIMIT TË BASHKISË

Nr. 147 prot.

Roskovec, më 19.07.2026

**PROJEKT – VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ .Datë 19.07 . 2026

**“PËR**

**MIRATIMIN E LISTËS SË PËR FITUESËVE NGA PROGRAMI PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE  
TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore "i ndryshuar, neni 24, Ligjit Nr. 22/2018 "Për Strehimin Social"; VKM-së Nr.454, datë 03.07.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", Udhëzimit Nr. 31 datë 18.11.2019, "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit"; Vendimit Nr. 384, datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore";

**Ju paraqesim për diskutim dhe miratim:**

1. Miratimin e listës së përfituesëve nga programi “Përmirësim i kushteve të banimit për komunitet e varfëra dhe të pafavorizuara për vitin 2026-2027”, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet komisioni i strehimit për kryerjen e procedurave përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.

Konceptoi: A. Profka

Xh. Duka

Miratoi: E. Kuqo

Konfirmoi: D. Hoxha

Për Drejtorinë Juridike : V. Zeqo.

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3(tre)

**KRYETAR**  
**Majlinda Bufi**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZËVENDËSKRYETARI**

**Maksim Goga**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 1427/prot.  
11

Roskovec, më 19.02.2026

**RELACION**

**"PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFITUESE NGA PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETET TË VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA"**

**KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC**

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore "i ndryshuar, neni 24, Ligjit Nr. 22/2018 "Për Strehimin Social"; VKM-së Nr.454, datë 03.07.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", Udhëzimit Nr. 31 datë 18.11.2019, "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit"; Vendimit Nr. 384, datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore";

Bashkia Roskovec ka aplikuar për fonde investimi "Për Përmirësimin e Banesave Ekzistuese për Komunitetet e Varfëra dhe të Pafavorizuara".

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit me shkresën Nr. 628/2prot., datë 23.01.2026 "Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2026", ka njoftuar të gjitha njësitë vendore mbi fondet e planifikuara për programet e strehimit për vitin 2026, duke i ftuar të aplikojnë për mbështetje buxhetore sipas ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 "Për strehimin social", të ndryshuar. Njoftimit për aplikim i bashkëlidhen "Termet e referencës për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2026-2027",

Programi i Përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara realizohet nëpërmjet grantit konkurrues për financimin e plotë ose të pjesshëm nga buxheti i shtetit të projekteve që propozohen nga njësitë e qeverisjes vendore. Për vitin 2026, Bashkia Roskovec ka zgjedhur të aplikojë në programin e përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara në projektin përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese.

Përzgjedhja e Bashkisë Roskovec për të aplikuar në programin e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara nisët nga rëndësia e këtij projekti për të siguruar jetën e banorëve të rrezikuar, nga kushtet e tyre familjare, ekonomike dhe sociale të vështira dhe të pamundësisë financiare për të përballuar me të ardhurat e tyre punimet e përmirësimit të kushteve fizike të banesave ku jetojnë.

Familjet që përfitojnë nga ky projekt bëjnë pjesë në kategoritë e mëposhtme:

- familje me të ardhura të ulët.
- familje me persona PAK, NE, KEMP
- pensionist

**Shënim:** Të gjithë aplikantët e kualifikuar në listën përfituese kanë paraqitur çertifikatën e pronësisë së banesës.

Grupi i ngritur i punës në Bashkinë Roskovec, ka bërë verifikimin faktik të banesave në terren.

Të gjitha familjet paraqesin dokumentacion të plotë për kushtet familjare, kushtet ekonomike dhe kushtet sociale për çdo anëtar të saj. Nisur nga këto kushte të patjetërsueshme, është bërë edhe përzgjedhja e familjeve që do të përfitojnë nga ky projekt për vitin 2026.

Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit, komisioni përgjegjës ka hartuar listën përfundimtare të familjeve që plotësojnë kriteret për të përfituar nga ky program.

Miratimi i kësaj liste është i domosdoshëm për të vijuar me procedurat administrative dhe financiare për zbatimin konkret të ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve të banimit, në përputhje me fondet e miratuara dhe planifikimin buxhetor.

Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit Bashkiak, miratimin e listës përfituese nga Programi i Strehimit “Përmirësim i Kushteve të Banimit për Komunitetet e Varfra dhe të Pafavorizuara”, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

#### **Komisioni i Strehimit:**

- Maksim Goga – Kryetar
- Suela Çepele – Anëtar
- Enkeleda Kola - Anëtar
- Vjollca Zeqo - Anëtar
- Edlira Toro - Anëtar
- Eneida Hoxha – Anëtar
- Ronada Hoxha - Anëtar

*Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3(tre)*

**K R Y E T A R**  
**Majlinda Bufi**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZËVENDËSKRYETAR**  
**Maksim Goga**

*Lista e përfituesëve për përmirësim banese 2026*

| Nr. | Emër Mbiemër<br>(kr.yefamiljari) | Nr. total i<br>anëtarëve në<br>familje, sipas<br>certifikatës<br>familjare të 3<br>muajve të<br>fundit | Kategoria së cilës i<br>përket, sipas nenit<br>16 të ligjit.nr.<br>22/2018 | Të ardhurat<br>mesatare Mujore<br>(lekë) | Vendbanimi |
|-----|----------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|------------|
| 1   | Lorand Haredin Dervishaj         | 6                                                                                                      | PAK                                                                        | 20000                                    | Luar       |
| 2   | Zonjë Riza Tafa                  | 6                                                                                                      | NE                                                                         | 3405                                     | Suk 2      |
| 3   | Vajde Agim Zeka                  | 3                                                                                                      | KEMP                                                                       | 0                                        | Roskovec   |
| 4   | Liri Elmaz Tafa                  | 1                                                                                                      | Pensionist, KEMP                                                           | 23620                                    | Kuman      |
| 5   | Baftjar Shaban Driza             | 3                                                                                                      | PAK                                                                        | 0                                        | Velmish    |

**Komisioni:**

Maksim Goga  
Eneida Hoxha  
Suela Çepele  
Ronada Hoxha  
Enkeleda Kola  
Vjollca Zeqo  
Edlira Toro

**K R Y E T A R**  
Majlinda Bufi

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
ZËVENDËSKRYETAR**

Maksim Goga

